



National Centre for Community Services
Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare

Telafoni: +35542273247 Email: ncca.albania@gmail.com Website: www.ncca-al.com

Janar 2024

Fletë Faktesh

*Qasja në arsimin e mesëm
dhe të lartë për gratë dhe
vajzat rurale, ato më aftësi
ndryshe dhe gratë rome dhe
egjiptiane*

Qendra Kombëtare për Shërbime
Komunitare



Tabela e Përmbajtjes

I.	HYRJE	1
I.1.	Legjislacioni për Arsimin në Shqipëri	1
II.	GRATË DHE VAJZAT ROME	2
II.1	Të dhëna demografike	2
II.2	Kuadri Ligjor dhe Politikat	2
II.3	Arsimimi i romëve dhe egjiptianvë dhe Sfidat	2
II.4	Barazia Gjinore dhe Edukimi i Grave dhe Vajzave	3
II.5	Rekomandime për ministrinë dhe institucionet përgjegjëse	4
III.	GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI NDRYSHE	5
III.1	Legjislacioni dhe statistikat	5
III.2	Regjistrimi dhe përfundimi i niveleve të ndryshme arsimore	5
III.3	Sfidat e përfshirjes në shkollat e përgjithshme	5
III.4	Rekomandime për ministrinë dhe institucione përgjegjëse	5
IV.	GRATË DHE VAJZAT RURALE	6
IV.1	Rezultatet e PISA 2022	6
IV.2	Regjistrimi i pabarabartë vajza-djem	7
IV.3	Pengesat infrasktrukturore dhe të lidhura me varfërinë	8
IV.4	Sfidat shtrihen në fushën e gjinisë dhe zhvillimit rural	8
IV.5	Financimi për arsimin në rajon dhe fshatra	8
IV.6	Rekomandime për ministrinë dhe institucione përgjegjëse	8



Një vështrim i përgjithshëm i qasjes në arsimin e lartë për gratë dhe vajzat nga zonat rurale, gratë me aftësi ndryshe dhe gratë Rome dhe egjiptiane.

V. HYRJE

Qasja në arsimin e lartë për gratë dhe vajzat rurale, gratë me aftësi ndryshe si edhe grate rome dhe egjiptiane në Shqipëri, paraqet sfida të ndryshme. Gratë dhe vajzat rurale ballafaqohen me vështirësi logjistike dhe kufizime ekonomike, ndërsa grupet e tjera përballen me diskriminim dhe mungesë ndërgjegjësimit kulturor nga ana e publikut gjithashtu me vështirësi infrastrukture. Rekomandohet përmirësimi i qasjes përmes programeve të shkollimit sa më afër vendbanimit, mbështetjes financiare dhe ndërgjegjësimit kulturor. Gjithashtu, nevojitet hartimi i politikave gjithpërfshirëse dhe të përgjegjshme për të siguruar një arsim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë këta komunitete.

I.1 Legjislacioni për Arsimin në Shqipëri

Arsimi Para-Universitar

Ligi No.69/2015 "Mbi arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar nga aktet nënligjore përkatëse

Arsimi i lartë

Ligji Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore përkatëse¹

Arsimi profesional

- Ligji Nr. 15/2017 datë 16.02.2017 "Për Arsimin dhe Formimin

¹<https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij/>.

Profesional në Republikën e Shqipërisë"²

"Strategjia e re mbi arsimin 2021-2026" për herë të parë përfshin të gjitha ciklet e arsimit duke filluar nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë. Vizioni i strategjisë është të ofrojë arsim cilësor bazuar në parimet përfshirëse dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Pavarësisht legjislacionit gjithpërfshirës që mundëson edukimin e barabartë, gjithpërfshirës për të gjithë, vajzat dhe gratë në Shqipëri kanë një nivel më të ulët arsimimi sesa djemtë apo burrat. Në vitin 2020, u vu re se 54% e grave mbi moshën 25 vjeç janë vetëm me arsim fillor ose tetë/nëntë vjeçar. Një statistikë që pasqyron nivelin e ulët të arsimit për këtë grup gjinor. Burrat e moshës mbi 25 vjeç janë në një nivel më të përparuar krahasuar me gratë, me vetëm 44% të tyre që kanë arsim fillor ose tetë/nëntë vjeçar dhe shumica ndjekin një nivel më të lartë studimesh. Sa i përket arsimit të mesëm, gratë janë gjithashtu në një situatë më të diskriminuar se burrat. Gratë mbi 25 vjeç përbëjnë vetëm 27% të nxënësve me arsim të mesëm, ndërsa burrat e të njëjtës grupmoshë përbëjnë 40%.

Kur bëhet fjalë për analfabetizmin, të dhënat e fundit të ofruara nga shteti shqiptar që datojnë në vitin 2012, tregojnë nivelin e analfabetizmit 3.9% për gratë në krahasim me vetëm 1.6% për burrat.³

Investimi në arsim sjell shumë përfitime për individin dhe vendin në tërësi. Nëse qeveria shqiptare do të ndiqte një politikë që do të arrinte të sillte në shkollë dhe do të diplomonte 4,000 fëmijë të moshës së shkollës së mesme- gjysmën e atyre që aktualisht janë jashtë shkollës, fitimi do të ishte 3.4 milionë dollarë amerikanë ose 0.03% e Prodhimit të Brendshëm Bruto

² <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/ligj-nr-15-dt-16-2-2017.pdf>

³ <https://ndiqparate.al/?cat=1928&lang=en>



(PBB-së), e cila është 11.5 miliardë dollarë amerikanë për vendin.⁴

E rëndësishme

Shqipëria është në mes të një krize demografike ndërsa dhjetëra mijëra njerëz largohen çdo vit nga vendi dhe popullsia që mbetet është e rrënuar nga plakja dhe rënia e lindshmërisë. Deri në 42,000 njerëz emigrojnë çdo vit. Një studim i fundit raportoi se deri në 40% e atyre që kanë emigruar janë me arsim të lartë, përfshirë mësuesit dhe personelin akademik⁵.

II. GRATË DHE VAJZAT ROME

II.1 Të dhëna demografike

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC) vlerëson një popullsi prej 120,000 romësh në Shqipëri, por përtej shifrave, si komuniteti rom ashtu edhe ai egjiptian njihen zyrtarisht si minoritete dhe jetojnë në të gjithë vendin⁶. Në dekadën e fundit, qeveria shqiptare ka rritur përpjekjet për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në të gjitha sferat e zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik.⁷

II.2 Kuadri Ligjor dhe Politikat

Ligjet kryesore përfshijnë Ligjin e vitit 2018 për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Ligjin e vitit 2013 mbi Arsimin Parauniversitar, Ligjin e vitit 2018 për Strehimin Social dhe Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve të 2017.

Plani i ri i Veprimit për Romët 2020-2025 është parë si një mundësi për të trajtuar sfidat që has ky komunitet. Sistemi i mbledhjes së të dhënave RomAlb vlerësohet, por çështjet e vazhdueshme, të tilla si kufizimet buxhetore, koordinimi

ndërinstitucional, qarkullimi i burimeve njerëzore dhe problemet e transparencës, vazhdojnë të jenë pengesa për zbatimin efektiv të politikave⁸.

II.3 Arsimimi i romëve dhe egjiptianëve dhe Sfidat:

Në vitin shkollor 2021-2022, 10.933 nxënës me prejardhje romë dhe egjiptiane u regjistruan në arsimin fillor, por vetëm 856 ndoqën arsimin e mesëm (MA, 2022). Rezultatet arsimore të nxënësve romë dhe egjiptianë ishin ndër më të ulëtat në Shqipëri (Byrne, Kulluri, Gedeshi, 2021) dhe normat e braktisjes së shkollës janë afër 50% (UNICEF, 2017 cituar Byrne, Kulluri, Gedeshi, 2021).⁹

Disa studiues argumentojnë se vetëm arsimi i detyrueshëm nuk e kapërcen hendekun e regjistrimeve. Në vitin 2017, ka pasur një pabarazi prej 31% në regjistrimin e detyrueshëm në arsim midis romëve dhe moshatarëve jo-romë në Shqipëri, duke treguar se një e treta e fëmijëve romë të moshës 7-15 vjeç ishin të përjashtuar (Robayo-Abril & Millan, 2019). Prioritizimi i regjistrimit pa nisma shitesë për përfundimin e suksesshëm të shkollës nuk trajton në mënyrë efektive sfidat arsimore me të cilat përballen fëmijët romë.

⁴<https://www.unicef.org/albania/media/451/file/The%20Cost%20of%20Underinvestment%20in%20Education%20and%20ways%20to%20reduce%20it.pdf>

⁵https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/albania-headed-for-labour-market-crisis-due-to-youth-emigration/

⁶https://www.romaeducationfund.org/wp-content/uploads/2022/01/FINAL_ECD-and-Primary.pdf

⁷<https://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2022/03/NATIONAL-ACTION-PLAN-FOR-EQUALITY.pdf>

⁸https://www.romaeducationfund.org/wpcontent/uploads/2022/01/FINAL_ECD-and-Primary.pdf

⁹<https://www.esap.online/download/docs/European%20Pillar%20of%20Social%20Rights%20%20ALBANIA%20FINAL.pdf/cdc04160125dcbe22147da7cf86cfec2.pdf>




Normat e regjistrimit të romëve dhe egjiptianëve në arsimin parashkollor (mosha 3-5 vjeç) janë dukshëm më të ulëta në krahasim me ato të popullsisë së shumicës (përkatësisht 33% dhe 64%)¹⁰. Boshllëqet etnike në arritjen e arsimit po zgjerohen më tej në arsimin e mesëm dhe të lartë. Për më tepër, një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet dallimeve midis regjistrimit, pjesëmarrjes dhe normave të përfundimit. Ndërsa nuk ka të dhëna kombëtare të besueshme mbi normën e pjesëmarrjes, përfaqësuesit lokalë, veçanërisht organizatat rome po paralajmërojnë se hendeku etnik zgjerohet

II.4 Barazia Gjinore dhe Edukimi i Grave dhe Vajzave:

Treguesit e arsimit për gratë rome dhe egjiptiane në Shqipëri dëshmojnë se hendeku gjinor vazhdon të ekzistojë.

Normat e arsimimit parashkollor dhe të detyrueshëm për vajzat janë më të ulëta se për djemtë (30% dhe 35%, 66% respektivisht). Por normat e përfundimit zgjerojnë hendekun gjinor (39% për vajzat, 47% për djemtë), me braktisje në një raport të zhdrejtë tek vajzat. Arsimi i mesëm dhe ai i lartë tregojnë një minimum prej 1%



më tej në këtë pikë. Pak romë përfundojnë arsimin e mesëm (15% në krahasim me 75% të popullatës së shumicës). Normat e përfundimit të arsimit të lartë janë afër zeros tek romët dhe egjiptianët (1% në krahasim me 25% në shumicën e popullsisë)¹¹.

diferencë ndërmjet sekseve gjithashtu norma të ulëta regjistrimi për të dyja seks

¹⁰ Thyerja e ciklit të përjashtimit të romëve në Ballkanin Perëndimor 2019, <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/breaking-cycle-of-roma-exclusion-in-western-balkans>

¹¹ Raporti i ECRI për Shqipërinë (cikli i gjashtë i monitorimit), <https://rm.coe.int/report-on-Albania-6th-monitoring-cycle-/16809e8241>

II.5 Rekomandime për ministrinë dhe institucionet përgjegjëse duke përfshirë edhe OJQ-të

1. Mbledhja dhe mbrojtja e të dhënave të plota

Avokoni për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave gjithëpërfshirëse, me fokus në aspektet etnike dhe ndarjen sipas gjinisë, posaçërisht për komunitetet rom dhe egjiptian.

2. Promovimi i regjistrimit të hershëm parashkollor

Theksojini përfitimet e regjistrimit të hershëm parashkollor për fëmijët romë dhe egjiptianë, përmes historive të suksesit dhe ofrimit të programeve mbështetëse.

3. Programet për prindërit dhe nismat përfshirëse

Zhvilloni programe për prindërit duke u përqëndruar tek suksesi i bibliotekave të lojërave¹² për fëmijët romë, të cilat përfshijnë edhe prindërit. Inkurajoni bashkëpunimin mes qeverive lokale, shkollave dhe OJQ-ve.

4. Hartimi i planeve lokale me një perspektivë të të drejtave të bazuar në gjini

Avokoni për plane lokale që mbështesin arsimin rom, duke përfshirë një perspektivë të të drejtave të bazuar në gjini dhe një mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi (M&E).

5. Fuqizimi i komuniteteve nëpërmjet ndërgjegjësimit/informimit

Organizoni fushata ndërgjegjësimi/informimi brenda komuniteteve rom dhe egjiptian, duke u fokusuar tek gratë dhe vajzat dhe duke promovuar edukimin, trajnimin profesional dhe punësimin.

6. Zhvillimi i programeve të kujdestarisë për një arsim gjithëpërfshirës

Shtojini përpjekjet në zhvillimin e programeve të kujdestarisë, duke përfshirë mbështetjen emocionale dhe akademike për fëmijët romë dhe egjiptianë. Këto programe duhet të ofrojnë ndihmë për mbrojtjen nga faktorët e rrezikut për braktisje të shkollës dhe të nxisin pjesëmarrjen e prindërve në procesin arsimor të fëmijëve.

7. Roli vendimtar i kujdestarisë dhe përpjekjeve bashkëpunuese

Kushtojini rëndësi kujdestarisë dhe mësimave shtesë për fëmijët romë dhe egjiptianë. Bashkëpunoni me Ministrinë e Arsimit dhe OJQ-të për të hartuar programe të ndjeshme ndaj gjinisë, për të siguruar mbështetjen e nevojshme për sukses akademik, duke përfshirë dhe thelluar përpjekjet në fushën e kujdestarisë për fëmijët në nevojë.

¹² <https://www.cei.int/news/6198/toy-libraries-conference-reducing-the-gap-in-early-childhood-education-of-roma-opportunities-and>



III. GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI NDRYSHE

III.1 Legjislacioni dhe statistikat

Sipas statistikave zyrtare, në Shqipëri, janë 144.859 persona me aftësi ndryshe, ose 4.9% e popullsisë, të regjistruar si përfitues të pensionit të invaliditetit ose shërbimeve shtetërore të invaliditetit. Sipas Censurit të vitit 2011, 6.2% e popullsisë mbi 15 vjeç, ose 137.435 persona, kanë një formë paaftësie, nga të cilët 75.239 (54.7%) janë femra.¹³ Shqiptarët me aftësi ndryshe përjetojnë nivele të larta papunësie, shpesh nuk kanë qasje në mundësitë bazë për ndihmë mjekësore dhe arsim dhe vuajnë stigmatizimin dhe izolimin nga shoqëria. Legjislacioni shqiptar parashikon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por kjo ka ndikuar pak tek integrimi i njerëzve me aftësi ndryshe në shoqërinë shqiptare¹⁴.

Gjatë dekadës së fundit, janë bërë përpjekje për të zhvilluar një kuadër ligjor rregullues, të përshtatshëm që do të garantonte përfshirjen e fëmijëve me aftësi ndryshe në të gjitha shkollat e përgjithshme. Ligji Nr. 69/2012, i miratuar në korrik 2012 "Për Arsimin Parauniversitar"¹⁵ shënon një hap të rëndësishëm në lidhje me të drejtat e fëmijëve me aftësi ndryshe, për përfshirjen e tyre dhe edukimin e përgjithshëm cilësor. Ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi Ndryshe (2006) (UNCPRD) nga Shqipëria (2012) mund të konsiderohet një epokë e re në lidhje me të drejtat e individëve me aftësi ndryshe.¹⁶ Por shteti shqiptar ende nuk ka miratuar Protokollin Opsional të Konventës. Përveç kësaj, si Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, ashtu edhe Ligji "Për mbrojtjen nga

diskriminimi" nuk kanë nocionin e diskriminimit të shumëfishtë lidhur me diskriminimin e grave me aftësi ndryshe, bazuar në gjininë dhe paaftësinë e tyre.

III.2 Regjistrimi dhe përfundimi i niveleve të ndryshme arsimore

Fëmijët, me aftësi ndryshe veçanërisht vajzat hasin vështirësi në ndjekjen e shkollës. Sipas Ministrisë së Arsimit, shkalla e fëmijëve me aftësi ndryshe që ndjekin shkollën u rrit nga 75 për qind në vitin 2014 në 85 për qind në vitin 2018, megjithëse kjo i referohet vetëm 57,6 për qind të fëmijëve të moshës 6-17 vjeç që marrin ndihmë për paaftësinë. Cilatdo qofshin shifrat reale, fëmijët me aftësi ndryshe janë të nënpërfaqësuar në shkollat kryesore dhe sfida e parë në mbështetjen e tyre mund të jetë identifikimi i tyre. Gonzales¹⁷ pohon se prindërit dhe fëmijët mund të ngurrojnë të identifikojnë fëmijët me aftësi ndryshe nga frika e stigmatizimit dhe bullizmit dhe se kjo i pengon ata të marrin mbështetje shtesë. Shifrat e INSTAT tregojnë se, për vitin akademik 2018–2019, ndërmjet nxënësve me aftësi ndryshe që ndiqnin arsimin e mesëm, përqindja e vajzave ishte më e ulët se ajo e djemve (përkatësisht 33.2% dhe 39.2%), ndërsa shifra për arsimin e lartë ishte deri në 58.4 për qind.

III.3 Sfidat e përfshirjes së të rinjve me aftësi ndryshe në shkollat e përgjithshme

Shkollat po zbatojnë parimet e arsimit gjithpërfshirës. Gjithashtu raportohet se mësuesit janë pozitivë në lidhje me qasjen gjithpërfshirëse të arsimit, por pavarësisht këtyre përpjekjeve, Raporti Vjetor për Vendin 2019 tregon se cilësia e arsimit për

¹³<https://www.undp.org/sites/g/files/zskqke326/files/202205/Inclusive%20vocational%20education%20and%20trainin g%20for%20persons%20with%20disabilities%20in%20Alb ania%20-%20English.pdf>

¹⁴<https://2017-2020.usaid.gov/albania/news-information/fact-sheets/fact-sheet-support-persons-disabilities-and-disability-rights>

¹⁵ [1] Law No. 69/2012 "For pre-university education system in the Republic of Albania. [Ligj nr.69/2012, "Për sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"]

¹⁶<https://www.undp.org/albania/publications/inclusive-vocational-education-and-training-persons-disabilities-albania-%E2%80%93-evaluation-report>

¹⁷ <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/32145740/>




fëmijët me aftësi ndryshe është ende një shkak për shqetësim. Vështirësitë mbeten në organizimin e transportit shkollor për fëmijët me aftësi ndryshe dhe mësuesit ndihmës kërkojnë trajnim të mëtejshëm të përshtatur.

Ndërkohë, vlerësimi i paaftësive bazohet ende në një model mjekësor të vjetëruar dhe mbikqyrja se si po zbatohen masat lidhur me paaftësinë pengohet nga mungesa e të dhënave. Duke pasur parasysh angazhimet kombëtare për regjistrimin e të gjithë fëmijëve me aftësi ndryshe në shkollat e rregullta, trajnimi i mësuesve duhet të prioritizojë dhe mësimdhënien që lufton paragjykimet dhe

stereotipet në klasë. Gjithashtu trajnimi rreth nevojave të veçanta duhet të jetë një element i detyrueshëm gjatë përgatitjes së mësuesve të rinj, trajnimit në shërbim dhe sistemeve të mbështetjes profesionale.¹⁸

Përveç kësaj, mjaft faktorë, ndër të cilët vlen të theksohet mungesa e burimeve financiare dhe kapaciteteve njerëzore, paraqesin sfida dhe vështirësi në adresimin e çështjeve me të cilat përballen personat me aftësi ndryshe përfshirë edhe fëmijët në moshë shkollore, si edhe ngadalësojnë përpjekjet e tyre për të marrë arsim, trajnim, punësim, për të pasur akses në shërbime dhe për t'u përfshirë në shoqë



III.4 Rekomandime për ministrinë dhe institucionet përgjegjëse duke përfshirë edhe OJQ

¹⁸<https://www.unicef.org/albania/media/4071/file/SituationAnalysisofChildrenandAdolescentsinAlbania.pdf>



- 1. Planet e individualizuara të arsimit dhe ndihma mësimore**
Hartimi dhe zbatimi i planeve të individualizuara të edukimit për nxënësit me aftësi ndryshe, me një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë duke përfshirë asistentë mësimore të mbështetur nga komitetet e vlerësimit të nevojave arsimore.
- 2. Materiale didaktike përfshirëse**
Siguroni materiale didaktike përfshirëse për nxënësit me aftësi ndryshe në shkollat e arsimit profesional, duke trajtuar sfidat që lidhen me gjininë.
- 3. Rritje dhe Trajnim i Vazhdueshëm për mësuesit ndihmës**
Qeveria duhet të prioritetizojë rritjen e numrit të mësuesve ndihmës dhe të investojë në trajnime të vazhdueshme të ndjeshme ndaj gjinisë për personelin arsimor që punon me nxënësit me aftësi ndryshe.
- 4. Investimet në institucionet parauniversitare**
Të investojë në përmirësimin e cilësisë arsimore me ndjeshmëri ndaj gjinisë për fëmijët me aftësi ndryshe në institucionet parauniversitare. Fokusi në infrastrukturën, transportin dhe rimbussimin e kostos.
- 5. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit arsimor**
Përmirësimi i cilësisë së shërbimit arsimor duke optimizuar funksionet e bordit të shkollës, duke hartuar programe individuale të edukimit (IEPs) cilësore me perspektivë gjinore dhe duke diversifikuar shërbimet në dhe jashtë shkollës. Ofrimi i trajnimeve gjithëpërfshirës të ndjeshëm ndaj gjinisë për një mjedis shkollor jo diskriminues.
- 6. Trajnimi i mësuesve për një përfshirje kuptimplotë**
Prioritetizimi i trajnimit të ndjeshëm ndaj gjinisë për personelin mësimor, duke theksuar përfshirjen kuptimplotë të fëmijëve me aftësi ndryshe në arsimin e zakonshëm.
- 7. Investimi në programet përfshirëse të fëmijërisë së hershme**
Investimi në programet arsimore përfshirëse të fëmijërisë së hershme me një perspektivë gjinore për identifikimin dhe referimin e hershëm.
- 8. Fushatat sensibilizuese/informuese:**
Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere/informuese kundër diskriminimit, duke theksuar perspektivën e të drejtave të njeriut dhe ndikimin pozitiv të qasjes gjinore-përfshirëse në zhvillimin social dhe demokratik në Shqipëri.

IV. GRATË DHE VAJZAT RURALE

IV.1 Rezultatet e PISA 2022

Sfidat arsimore në Shqipëri janë të dukshme. Performanca e dobët në testet e Programit të Vlerësimit Ndërkombëtar të Nxënësve, PISA pasqyron një shqetësim mbizotërues në lidhje me cilësinë e arsimit. Për shembull rezultatet e “PISA 2022” tregojnë se Shqipëria është renditur në vendin e 62, ndër 80 vendet që kanë marrë pjesë në testim.¹⁹

IV.2 Regjistrimi i pabarabartë vajza-djem

Këto sfida janë veçanërisht të theksuara në zonat rurale, malore dhe të izoluara, ku shkollat luftojnë për të tërhequr mësues të mirëkualifikuar. Vajzat dhe djemtë nga zonat rurale përballen gjithashtu me norma më të ulta regjistrimi në shkollat e mesme dhe profesionale. Shkollat profesionale dhe qendrat e trajnimit të të rriturve janë kryesisht të vendosura në Shqipërinë qendrore, duke lënë zonat rurale pa qasje. Pavarësisht se arsimin e mesëm e përfundojnë më shumë vajza sesa djem

¹⁹<https://www.oecd.org/publication/pisa-2022-results/country-notes/>



arsimi profesional mbizotërohet nga djemtë, me një raport prej 367 djem për çdo 100 vajza.²⁰

IV.3 Pengesat infrastrukturore dhe të lidhura me varfërinë

Përveç pabarazive të regjistrimit, vajzat në zonat rurale hasin vështirësi në qasjen ndaj shërbimeve arsimore për shkak të çështjeve të lidhura me infrastrukturën arsimore në zonat e largëta, distancave të gjata deri në shkollë, mungesës së transportit dhe një ndjenje të përhapur pasigurie si për vajzat, ashtu edhe për familjet e tyre. Kostoja financiare e arsimit të lartë kufizon më tej të drejtat e grave rurale për të ndjekur studimet e avancuara.

Ndërsa normat e shkollimit bazë duken ekuivalente për vajzat dhe djemtë, qasja në arsimin e lartë lidhet drejtpërdrejt me gjendjen ekonomike të familjes. Ekziston një kontrast i thellë midis familjeve të pasura, ku 28 për qind e grave dhe 31 për qind e burrave nga familjet me të ardhura më të larta kanë njëfarë arsimimi, krahasuar me vetëm një për qind të të dy gjinive nga familje me të ardhura të ulëta²¹.

IV. 4 Sfidat shtrihen në fushën e gjinisë dhe zhvillimit rural.

Pavarësisht përpjekjeve të qeverisë shqiptare për të adresuar pabarazitë gjinore, mbetet një hendek midis legjislacionit dhe zbatimit. Ky hendek është më i theksuar në pabarazitë gjinore të pranuar dhe të toleruara nga shoqëria në zonat rurale, ku normat e rrënjosura

përbëjnë sfidë për zbatimin efektiv të ligjeve dhe politikave mbi barazinë gjinore. Pjesëmarrja e vajzave në formimin profesional dhe marrjen e njohurive rreth bujqësisë dhe zhvillimit rural mbetet e kufizuar²².

IV.5 Financimi për arsimin në rajon dhe fshatra

Dispozitat në ligj kërkojnë një formulë të ndarjes së buxhetit të arsimit për nxënës, por zbatimi ende nuk ka ndodhur. Shpërndarjes së fondeve i mungon një formulë për shpërndarjen e fondeve të ministrisë në drejtoritë rajonale dhe zyrat lokale të arsimit. Investimi kapital është vendimtar për të siguruar standardet bashkëkohore për mjediset shkollore dhe infrastrukturën. Shumë shkolla, veçanërisht ato në zonat rurale, luftojnë për të përmbushur nevojat bazë të infrastrukturës si ngrohja, duke çuar në sfida në krijimin e mjediseve të mësimi me cilësi të lartë. Modelet e migrimit nga fshatrat në qytete kanë rezultuar në shkolla të mbipopulluara dhe struktura të papërshtatshme, duke përfshirë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit²³.

Si përfundim, trajtimi i sfidave shumëplanëshe në arsimin shqiptar kërkon një strategji gjithëpërfshirëse që trajton çështjet e arsimit rural, të pabarazive gjinore, qasjes së arsimit të lartë, financimit dhe infrastrukturës. Një metodë holistike është thelbësore për të nxitur përmirësime domethënëse në peisazhin arsimor të vendit

²⁰https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/202206/VET%20English%20Online_Oct%202%5B1%5D%5B26%5D.pdf

²¹<https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf>

²²https://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2021/12/Annex-1_Gender-Analysis.pdf

²³ <https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf>



IV. 6 Rekomandime për ministrinë dhe institucionet përgjegjëse duke përfshirë edhe OJQ-të

1. Zhvillimi i infrastrukturës

Përmirësimi i infrastrukturës së transportit për të lidhur zonat rurale të largëta me shkollat. Shkollat në zonat rurale, të pajisen me mjediset dhe burimet e nevojshme.

2. Mbështetja financiare

Ndihmë financiare, të tilla si bursa ose grante, për të mbuluar shpenzimet e lidhura me arsimin për vajzat e familjeve me të ardhura të ulëta. Incentivë për familjet që t'i dërgojnë vajzat e tyre në shkollë, të tilla si kredi të buta etj.

3. Fushata ndërgjegjësuere/informuese

Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit/informimit për të theksuar rëndësinë e edukimit për vajzat dhe gratë, duke trajtuar normat kulturore dhe stereotipet. Bashkëpunimi me udhëheqësit lokalë, influencuesit e komunitetit dhe udhëheqësit fetarë për të mbrojtur arsimimin e vajzave.

4. Angazhimi i komunitetit

Krijimi i programeve të edukimit me bazë në komunitet, të cilat plotësojnë nevojat specifike të zonave rurale. Përfshini prindërit, veçanërisht nënat, në aktivitetet shkollore dhe në proceset vendimmarrëse.

5. Mundësitë fleksibël të të mësuarit

Ofrimi i opsioneve fleksibël të të mësuarit, duke përfshirë klasat e mbrëmjes dhe programet e edukimit për të rritur, për të përshtatur orarin e grave dhe vajzave të përfshira në aktivitetet shtëpiake dhe bujqësore.

6. Integrimi i teknologjisë

Përdorimi i gjerë i teknologjisë për të dhënë mësim, veçanërisht në fushat ku ngritja e shkollave fizike mund të jetë sfiduese. Ofroni trajnime për shkrim-leximin dixhital si për gratë, ashtu edhe për vajzat, për të rritur qasjen e tyre në burimet arsimore online.

7. Shërbimet e kujdesit Shëndetësor

Përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor për të trajtuar pengesat që lidhen me shëndetin që i pengojnë vajzat të ndjekin shkollën. Zhvillimi i programeve të kujdesit për higjienën në shkollë për të siguruar një mjedis të shëndetshëm të mësuarit.

8. Trajnimi i mësuesve

Trajnime për mësuesit për të qenë të ndjeshëm ndaj nevojave të nxënësve vajza dhe për të krijuar një mjedis të mësuarit gjithpërfshirës dhe mbështetës.

9. Advokimi i politikave

Mbroni ndryshimet e politikave që kanë prioritet dhe mbështesin arsimin për gratë dhe vajzat rurale. Sigurohuni që politikat kombëtare të arsimit të trajtojnë sfidat specifike me të cilat përballen komunitetet rurale.

10. Partneritete dhe bashkëpunime

Bashkëpunoni me organizatat joqeveritare (OJF), agjencitë ndërkombëtare dhe organizatat lokale të bazuara në komunitet për të bashkuar burimet dhe ekspertizën. Krijoni partneritete me bizneset dhe industrinë për të krijuar mundësi të formimit profesional për vajzat.



E rëndësishme

- **Rritja e buxhetit të arsimit** është e nevojshme për të siguruar infrastrukturën e duhur fizike dhe të të mësuarit.
- **Investimi në Teknologji** në shkolla dhe universitete mund të revolucionarizojë arsimin në Shqipëri. Teknologjia dixhitale ka provuar të jetë një mjet efektiv në të mësuarit dhe të zgjerojë ndërveprimin midis nxënësve dhe mësuesve.
- **Mbështetje ekonomike dhe sociale për studentët e familjeve të marginalizuara** do të kontribuonte në vazhdimësinë e studimeve të tyre dhe në arsimimin e tyre dhe përparimin.
- **Mësimi i bazuar në nevojat për punë si një strategji arsimore**, do të kontribuonte në pajisjen e të rinjve me përvojë pune në jetën reale, duke aplikuar aftësitë akademike dhe teknike dhe zgjerimin e mundësive.

Ky fact sheet u përgatit nga Qendra Kombëtare për Shërbime Komunitare, organizatë anëtare e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, në kuadrin e advokimit për zbatimin e Vërejtjeve Përmblyëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë 2023, në zbatim të projektit “Forcimi i kapaciteteve të organizatave anëtare të Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore për përgatitjen e raporteve hije dhe alternative për mekanizmat ndërkombëtarë, mbi të drejtat e njeriut në fushën e dhunës me bazë gjinore”.

Ky projekt po zbatohet nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në bashkëpunim me UN Women Albania në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj Grave” i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga tre agjencitë e UN, UN Women, UNDP dhe UNFPA në partneritet me qeverinë shqiptare”.

Shënim: Ky produkt është krijuar nga QKSHK dhe duhet theksuar se nuk përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.